



Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë

# **Informata mbi aktivitetet e Trupit bashkërendues**

(janar-dhjetor 2012)

## **Shërbimi i Trupit Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës prezenton raportin e aktiviteteve për vitin 2012.**

Në përputhshmëri me prioritetet e definuara Shërbimi i Trupit Koordinues në periudhën që po e lëmë pas ka arritur rezultate dhe suksese të rëndësishme:

**a) Në sferën e ekonomisë** – Shërbimi i Trupit Koordinues në mënyrë të drejtpërdrejtë ka investuar në zhvillimin ekonomik dhe infrastrukturor në këto tri komuna. Me qëllim të përmirësimit të gjendjes ekonomike në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë ka ndarë 40 milionë dinarë mjete të pakthyeshme ndërmarrësve të tri komunave. Në projektet infrastrukturore në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës janë investuar 222.080.840,33 dinarë.

**b) Në sferën e integritit** – Me mbështetjen e ambasadës së Britanisë së Madhe, Shërbimi i Trupit Koordinues organizon pa pagesë „Shkollën e gjuhës serbe për të rinjtë shqiptarë nga komuna e Bujanocit dhe Preshevës“, e cila do të zgjasë shtatë muaj.

Në zyren e Shërbimit të Trupit Koordinues në Beograd praktikantët e komunitetit shqiptar nga komuna e Bujanocit dhe Preshevës arrijnë njohuri dhe përvojë të rëndësishme të cilat do t'u ndihmojnë atyre që në të ardhmën më lehtë të punësohen.

Në periudhën e lartëpërmendur Shërbimi i Trupit Koordinues ka shpallur tre konkurse për ndarjen e mjeteve për projektet e shoqërisë civile dhe për mbështetjen e mediave. Komisionin për përzgjedhjen e projekteve e përbën nga një përfaqësues prej secilës komunë dhe përfaqësuesit e Shërbimit të Trupit Koordinues. Në tre konkurse, Shërbimi i Trupit Koordinues ka aprovuar 7.789.880,00 dinarë për 21 projekte të shoqërive civile dhe mediave.

Komuna e Bujanocit ka dhënë pëlqimin për lokacionin në të cilin do të ndërtohet ndërtesa e paraleles së fakultetit Ekonomik nga Subotica në Bujanoc, e cila është hapur në tetor të vitit 2011. Shërbimi i Trupit Koordinues ka finansuar përpilimin e projektit urbanistik, përpilimin e zgjidhjes së konceptit arkitektonik dhe përpilimin e projektit për rrënimin e objektit ekzistues. Sëbashku me programin e EU Progres-it dhe komunën e Bujanocit, Shërbimi i Trupit Koordinues do të financojë ndërtimin e ndërtesës për nevojat e paraleles së fakultetit Ekonomik në Bujanoc.

**c) Në sferën e marrëdhënieve ndërkombëtare** – Me qëllim të përmirësimit të të gjitha aspekteve jetësore në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, Trupi Koordinues ka krijuar marrëdhënie të shkëlqyeshme me partnerët ndërkombëtarë: me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Republikën e Serbisë, ambasadën e Britanisë së Madhe, ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, OSBE zyren e Komisionerit të lartë për minoritete, misionin e OSBE-së në Republikën e Serbisë, USAID-in, programet EU Progres dhe PBILLD dhe shumë të tjerë.

**d) Në sferën e arsimit** – Është regjistruar gjenerata e dytë e studentëve në fakultetin Ekonomik nga Subotica në Bujanoc.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Këshillin Nacional të Shqiptarëve, janë siguruar 77 tekste shkollore për nxënësit e shkollave filllore të cilët e ndjekin mësimin në gjuhën shqipe.

Ky është viti i dytë që Shërbimi i Trupit Koordinues ndanë bursa për të rinjtë e komunës Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës për studim në fakultetet e Universitetit të Novi Sadit.

Janë ndarë 231 bursa për nxënësit e shkollave të mesme nga komuna e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.

Shërbimi i Trupit Koordinues ka siguruar bursa për studentët e paraleleve të dy fakulteteve në Medvegjë.

Për 1050 nxënës fillestarë janë siguruar çanta dhe mjete për shkollë.

**e) Në sferën e komunikimit me publikun** – Shërbimi i Trupit Koordinues i njofton qytetarët rreth punës së vet duke publikuar raporte dhe tekste në faqen e internetit ([www.kt.gov.rs](http://www.kt.gov.rs)), i dërgon raporte mbi punën Qeverisë së Republikës së Serbisë, mediave dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Në fillim të nëntorit të vitit 2012, profesor dr Zoran Stanković, u emërua kryetar i Trupit Koordinues. Ndërkaq, në fund të dhjetorit profesor dr Stanković u dërgoi letër në adresë të shtëpisë çdo qytetari nga këto tri komuna, me të cilën i njoftoi mbi rezultatet e Trupit Koordinues në vitin 2012 dhe aktivitetet e planifikuara për vitin e ardhshëm.

### **Aktivitetet kryesore të Shërbimit të Trupit Koordinues në vitin 2012 të paraqitura në mënyrë kronologjike:**

- **Janë ndarë mjete në konkursin e Shërbimit të Trupit Koordinues** – Në mars është shpallur konkursi i parë për realizimin e projekteve të shoqërive civile dhe mediave. Shërbimi i Trupit Koordinues organizatave dhe mediave për realizimin e projekteve në total i ka ndarë 5.051.380,00 dinarë. Shërbimit të Trupit Koordinues i kanë arritur gjithsej 37 propozime, ndërsa janë ndarë mjete për realizimin e 13 projekteve.

Janë ndarë mjete për projekte të cilat mirren me organizimin e manifestimeve sportive në të cilat marrin pjesë të rinjtë e tri etniciteteve, me mbrojtjen e ambientit, me arsimim, mësimin e gjuhës serbe, edukimin e fëmijëve të komunitetit romë dhe organizimin e ngjarjeve kulturore.

- **Bursa për të rinjtë nga Bujanoci dhe Presheva për studime në Universitetin e Novi Sadit** - Shërbimi i Trupit Koordinues në shkurt të vitit 2012 ka shpall konkurs për të rinjtë nga Bujanoci dhe Presheva për studime në fakultetet e Universitetit të Novi Sadit. Kjo është gjenerata e dytë e programit të ndarjes së bursave me të cilin inkurajohen të rinjtë nga jugu i Serbisë që të studiojnë në Republikën e Serbisë.

Në gjeneratën e parë janë regjistruar 11 studentë. Nëntë prej tyre kanë regjistruar vitin e dytë.

Kryetari i Trupit Koordinues profesor dr Zoran Stanković në dhjetor është takuar me 30 bursistë, studentë të vitit të parë dhe të dytë të studimeve, dhe në bisedën e përbashkët me ta dhe me rektorin Mirosllav Vesković, dekanët dhe prodekanët, u informua rreth përvojave të të rinjëve, kushtet e studimit dhe integrimin e tyre në mjedisin e ri.

Ndarja e bursave të rinjëve për studime në qytetin multietnik të Novi Sadit, do të kontribojë jo vetëm në përmirësimin e marëdhënies ndërmjet komuniteteve etnike në jug të Serbisë, por edhe avancimit të tyre profesional. Besojmë që këta të rinj me njohuritë e fituara, do të kontribojnë në përparimin e mjedisve nga të cilat vijnë.

- **Vizita e studentëve të paraleles së Fakultetit ekonomik nga Bujanoci, fakultetit amë –** Shërbimi i Trupit Koordinues në mars ka organizuar vizitën dy ditore për studentët e paraleles së



fakultetit Ekonomik nga Bujanoci në fakultetin amë në Suboticë. Vizita e studentëve të paraleles së fakultetit Ekonomik nga Bujanoci në Suboticë është edhe një aktivitet me qëllim të sigurimit të kushteve të domosdoshme për arritjen e arsimimit kualitativ dhe shkëmbimin e përvojave të studentëve të Bujanocit me kolegët e tyre nga Subotica dhe Novi Sadi. Gjatë vizitës studentët u njoftuan me kolegët e tyre, biseduan për iniciativat e përbashkëta në të ardhmen dhe panë si zhvillohen ligjeratat në Suboticë.

Në ditën e dytë të vizitës studentët nga Subotica dhe Bujanoci sëbashku ndjekën ligjeratat nga lënda e filozofisë. Kolegët nga Subotica u treguan atyre ndërtesën e fakultetit, ndërsa anëtarët e parlamentit të studentëve i udhëzuan ata lidhur me mënyrat e organizimit të organeve studentore, çka do të kontribuojë në avancimin e standardeve studentore dhe kushteve të shkollimit të lartë. Pas shoqërimit me kolegët nga fakulteti amë, studentët nga Bujanoci kanë vizituar kolegët të cilët studiojnë në paralelen e fakultetit Ekonomik në Novi Sad.

Trupi Koordinues do t'i përkushtohet edhe më tej avancimit të kushteve të studimit dhe krijimit të mundësive për studime kualitative në jug të Sërbisë.

- **Amfiteatri i ri në fshatin Klenik** – Fshati Klenik në komunën e Bujanocit është pasuruar me amfiteatr të ri i cili është hapur në mars të vitit 2012. Shërbimi i Trupit Koordinues ka ndihmuar në ndërtimin e amfiteatrit në shkollën fillore “Bora Stanković” në të cilin do të organizohen solemnitetet dhe ndodhitë e lidhura me jetën e shkollës. Amfiteatri kap vlerën prej 12 milion dinarësh dhe përfaqëson projekt të rëndësishëm së madhe për zhvillimin e jetës shoqërore të të gjithë banorëve të Klenikut dhe rrethinës.

Amfiteatri është hapur me rastin e shënimit të 165 vjetorit të ekzistimit dhe punës së shkollës, të cilën përveq nxënësve të fshatit Klenik e ndjekin edhe nxënësit e 9 fshatrave përreth.

- **Gjenerata e dytë e praktikantëve në institucionet shtetërore** – Zyra për të drejtat e njeriut dhe



pakicave, me mbështetjen e ambasadës së Britanisë së Madhe, për herë të dytë ka organizuar “programin për praktikë për pjesëtarët e minoriteteve në institucionet shtetërore të Republikës së Sërbisë”. Qëllimi i programit është rritja e pjesëmarrjes së minoriteteve, respektivisht përfaqësuesve romë, boshnjakë dhe shqiptarë në jetën publike dhe kyçja e tyre në organet shtetërore. Gjatë periudhës nëntor 2011 – prill 2012 dhjetë praktikantë janë njoftuar më mirë me punën e administratës shtetërore edhe atë në institucionet me rëndësi më të madhe për realizimin e drejtave kolektive të pakicave, në mesin e tyre edhe në zyret e Shërbimit të Trupit Koordinues në Beograd.

Gjatë gjashtë muajve praktikantët kanë qenë të inkuadruar në shumë aktivitete të cilët përfshijnë edhe bisedën me ambasadorin e Britanisë së Madhe E.T. Majkëll Devenport, vizitë Parlamentit Popullor, trajnime të shumta, vizita institucioneve kulturore. Gjatë kësaj kohe kanë arritur shoqëri të pandashme.

Dy praktikantë të komunitetit shqiptar nga komuna e Bujanocit dhe Preshevës kanë qëndruar gjashtë muaj në zyrën e Shërbimit të Trupit Koordinues në Beograd. Me ndihmën e mentores, u njoftuan me mënyrën e punës së administratës shtetërore dhe arritën njohuri të çmueshmë për avancimin dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm.

- **Janë ndarë mjete në konkursin e Shërbimit të Trupit Koordinues** – Shërbimi i Trupit Koordinues ka shpallur konkurs në muajin shtator për realizimin e projekteve të shoqërive civile dhe mediave në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Janë ndarë 1.254.000,00 dinarë për realizimin e katër projekteve.

- **Mjetet shkollore për nxënësit e klasave të para** – Edhe këtë vit për nxënësit e klasave të para nga tri komunat, Shërbimi i Trupit Koordinues ka siguruar çantat dhe mjetet shkollore. Nxënësve të shkollave fillore "9 maji" në fshatin Leran në komunën e Preshevës, "Branko Radiqeviq" dhe "Muharem Kadriu" në komunën e Bujanocit mjetet shkollore ia dorëzuan drejtoresha e Shërbimit të Trupit Koordinues Danijella Nenadiq, kryetari i komunës së Preshevës Ragmi Mustafa dhe shefi i kabinetit të kryetarit të komunës së Bujanocit, Arbër Pajaziti. Për këtë aktivitet (i katërti me radhë), Shërbimi i Trupit Koordinues ka ndarë 3.800.000,00 dinarë, ndërsa dhuratat i kanë marrë 1050 fillestarë.



- **Mjete të pakthyeshme për zhvillimin ekonomik të komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë** – Shërbimi i Trupit Koordinues në vitin 2012 për herë të parë ka siguruar mjete nga buxheti për financim të projekteve ekonomike me qëllim mbështetjeje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, sipërmarrësve privat dhe dyqaneve të produkteve bujqësore në shumë prej 40 milionë dinarësh.



Me mbështetjen e ambasadës së Britanisë së Madhe e në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Sërbisë, Shërbimi i Trupit Koordinues ka organizuar hulumtimin e kapaciteteve ekonomike të subjekteve tregtare në tri komunat. Në të gjitha fazat e hulumtimit dhe përpunimit të dokumenteve kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e komunave dhe Zyreve për zhvillim ekonomik lokal.

Rezultat i hulumtimit është "Analiza e kapaciteteve ekonomike" dhe "Programi i masave për ndarjen dhe shfrytëzimin e mjeteve për subvencionimin e ndërmarrjeve në vitin 2012".

Në këtë konkurs 15 projekte kanë fituar mjete të pakthyeshme për zhvillimin e kapaciteteve ekonomike edhe atë shtatë nga Bujanoci, pesë nga Presheva dhe tre nga Medvegja.

Ndërmarrësve kontratat ia kanë dorëzuar kryetari i Trupit Koordinues prof. dr Zoran Stanković, kryetari i komunës së Preshevës Ragmi Mustafa, kryetari i komunës së Bujanocit Nagip Arifi, kryetari i komunës së Medvegjës Slobodan Drashković dhe drejtoresha e USAID-it Suzan Fritz.

- **Shkolla e gjuhës serbe për të rinjtë shqiptarë nga komuna e Bujanocit dhe Preshevës –**



“Shkolla e gjuhës serbe” të cilën e organizon Shërbimi i Trupit Koordinues ka filluar punën në fund të nëntorit. Mësimin e gjuhës serbe e ndjekin 310 të rinjë shqiptarë të moshës 15 – 30 vjeçare nga komuna e Preshevës dhe Bujanocit. Shkolla e gjuhës serbe është pa pagesë dhe do të zgjasë 7 muaj. Për të gjithë pjesëmarrësit e shkollës, Shërbimi i Trupit Koordinues ka siguruar librat të cilësisë së lartë për mësimin e gjuhës serbe si gjuhë jo amëtare. Mësimi mbahet dy herë në javë, gjatë vikendit, në hapsirat e paraleles së fakultetit Ekonomik në Bujanoc dhe Shkollës së mesme teknike në Preshevë.

Katër profesoresha të shkollës së gjuhës nga Nishi, e cila është zgjedhur të organizojë mësimin për pjesëmarrësit e “Shkollës së gjuhës serbe” do të mundohen që të gjithë pjesëmarrësit përveç njohjen e gjuhës serbe. Në këtë do t’i ndihmojnë edhe asistentët lokal shqiptarë.

Numri i madh i të interesuarve për të mësuar gjuhën serbe si gjuhë jo amëtare tregon në nevojën, dëshirën dhe gatishmërinë që të mësohet gjuha e vendit ku jetojnë.

Shumicën e pjesëmarrësve të “Shkollës së gjuhës serbe” në të dy komunat e përbejnë nxënësit e shkollave të mesme por ka edhe mjaft student të paraleles së fakultetit Ekonomik në Bujanoc, të fakulteteve tjera dhe prej atyre që kanë ndërprerë procesin e shkollimit.

Pas shtatë muajve të gjithë pjesëmarrësit do të avancojnë njohjen e gjuhës serbe dhe do të marrin diploma të çertifikuara.

Iniciativën e Shërbimit të Trupit Koordinues , me të cilën të rinjtë shqiptarë fitojnë njohuri të gjuhës zyrtare në shtetin e tyre e mbështetë ambasada e Britanisë së Madhe në Republikën e Sërbisë.

- **Është shënuar përvjetori i punës së paraleles së fakulteti Ekonomik nga Subotica në Bujanoc -** Shërbimi i Trupit Koordinues i Qeverisë së Republikës së Sërbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë dhe fakulteti Ekonomik nga Subotica kah mesazhi i tetorit shënuan në mënyrë solemne fillimin e vitit të dytë të punës së paraleles së fakultetit Ekonomik nga Subotica në Bujanoc.

Vitin e kaluar në vitin e parë të studimeve janë regjistruar 69 studentë në kuadër të buxhetit. Këtë vit akademik është regjistruar numri i njëjtë i studentëve, studimi i të cilëve finansohet nga buxheti i Republikës së Sërbisë, edhe atë 34 nga komuniteti serb, 33 shqiptarë dhe 2 romë. Gjatë tërë vitit Shërbimi i Trupit Koordinues dhe Zyrja e komisionerit të lartë për pakica kanë organizuar mësimin e gjuhës serbe për studentët e komunitetit shqiptarë në mënyrë që ata më lehtë të përcjellin ligjeratat dhe t’i kalojnë provimet. Shërbimi i Trupit Koordinues ka përgatitur mësojtoret në të cilat studentët e vitit të dytë do të ndjekin ligjeratat dhe ka siguruar përkthimin e teksteve për studentët shqiptarë të vitit të parë dhe të dytë. Komuna e Bujanocit dhe Zyra e

komisionerit të lartë për pakica nacionale kanë paguar qiranë për hapsirat në të cilat gjenerata e dytë i ndjekin ligjeratat.

Ligjeratat në paralelen e fakultetit Ekonomik në Bujanoc zhvillohen në dy gjuhë. Studentët shqiptarë gjatë katër viteve të studimit kanë mundësi të ndjekin ligjeratat në gjuhën shqipe në 14 lëndë, me mundësinë e mbrojtjes së temës së diplomës në gjuhën amëtare. Ligjëruesit janë nga Subotica dhe Tetova.

Themelimi dhe puna e suksesshme deri më tani e paraleles së fakultetit Ekonomik është sukses i përbashkët i Fakultetit Ekonomik nga Subotica, Universitetit të Novi Sadit, Universitetit Shtetëror të Tetovës, Ministrisë së arsimit, Trupit Koordinues, komunës së Bujanocit, Këshillit Nacional Shqiptarë, Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe Qeverisë autonome të krahinës së Vojvodinës.

Partnerë dhe miq në këtë projekt shumë të rëndësishëm nga fillimi kanë qenë zyrja e Komisionerit të lartë për pakica dhe misioni i OSBE-së në Republikën e Serbisë. Kontribut dhe mbështetje të madhe kanë dhënë ambasada dhe organizata të shumta ndërkombëtare.

- **Gjenerata e re e praktikantëve në Beograd** – Zyrja e Shërbimit të Trupit Koordinues në Beograd për të dytën herë merrë pjesë në “Programin për praktikant të rinjë të komuniteteve minoritare”. Në periudhën nëntor 2012 – prill 2013 dy praktikantë nga komuniteti shqiptarë do të arrijnë shkathtësi dhe njohuri të reja.

Projektin e realizon Zyra për të drejtat e njeriut dhe pakicave me mbështetjen e ambasadës së Britanisë së Madhe dhe ambasadës së Holandës.

- **Janë ndarë mjete në konkursin e Shërbimit të Trupit Koordinues** – Në konkursin e tretë të Shërbimit të Trupit Koordinues të shpallur në nëntor të këtij viti janë ndarë 1.484.500,00 dinarë për realizimin e katër projekteve.
- **Shërbimi i Trupit Koordinues ndanë bursa për 231 nxënës të shkollave të mesme**



– Në konkursin e Shërbimit të Trupit Koordinues për ndarjen e bursave janë paraqitur 477 nxënës. Bursën e kanë marrë 231 prej tyre edhe atë 129 nxënës nga Presheva, 78 nga Bujanoci dhe 24 nga Medvegja. Bursat i kanë marrë nxënësit pa njërin ose të dy prindërit. Përveq kësaj, kriteret për ndarjen e bursave kanë qenë gjendja ekonomike e prindërve ose kujdestarit dhe suksesi i kandidatëve në vitin shkollorë paraprak. Shuma e bursës për një nxënës në muaj kap shumën prej 6.000,00 dinarësh dhe në këtë konkurs bursat e

ndara nxënësit i marrin deri në fund të vitit shkollorë.

Nxënësit e shkollave nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja të cilëve iu janë ndarë bursat kanë vizituar Beogradin. Në Parlamentin Popullor të Republikës së Serbisë bursat nxënësve ia dorzuan kryetari i Trupit Koordinues prof. dr Zoran Stanković, ministri i arsimit, shkences dhe zhvillimit teknologjik, Zharko Obradović dhe kryetari i bordit administrativ pranë parlamentit të Republikës së Serbisë, Zoran Babiq.

Pas vizitës në Parlamentin e Sërbisë, bursistët kanë qenë mysafirë të Kuvendit të qytetit të Beogradit ku i ka përshëndetur sekretarja për mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve dhe shkollim, Ljiljana Jovçiq. Gjatë qëndrimit në Beograd bursistët kanë parë ekspozita në “Muzeun e historisë së Jugosllavisë” dhe në “Shtëpinë e Luleve” dhe vizituan Pallatin e bardhë ( Beli dvor).

- **Përfundoi faza e parë e ndërtimit të njësisë së maternitetit në Preshevë** – Në mesin e muajit dhjetor në Preshevë u shënuar përfundimi i fazës së parë të punëve ndërtimore në njësinë e maternitetit. Në përdhësë të ndërtesës do të jetë reparti i gjinekologjisë, ndërsa në katin e parë dy salla për lindje dhe blloku spitalor. Shërbimi i Trupit Koordinues ka investuar 15, Ministria e shëndetësisë 20, ndërsa komuna e Preshevës 10 milionë dinarë. Për përfundimin e fazës së dytë të njësisë së maternitetit nevojiten 50 milionë dinarë, nga të cilat Trupi Koordinues në buxhetin për vitin e ardhshëm ka siguruar 10 milionë dinarë.

- **Është shënuar dymbëdhjetë vjetori i ekzistimit të Trupit Koordinues** – Trupi Koordinues



i Qeverisë së Republikës së Sërbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, festoi 12 vjetorin e themelimit. Mysafirëve në objektin e Banjës së Bujanocit iu është prezentuar filmi dokumentar mbi punën e këtij organi të Qeverisë gjatë dy viteve të fundit. Dhënia e bursave për nxënësit e shkollave të mesme dhe studentëve, shkolla e gjuhës serbe për të rinjtë shqiptarë, hapja e paraleles së Fakultetit ekonomik në Bujanoc, hapja e

Fakultetit ekonomik dhe juridik në Medvegjë, finansimi i projekteve ekonomike përmes dhënies së mjeteve të pakthyeshme ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, janë pjesë të punës së Trupit Koordinues në zonat e komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, të cilat përmes filmit dokumentar iu prezantuan të pranishmëve.

Kryetari i Trupit Koordinues, profesor dr Zoran Stanković tha që ky organ ka rolin kyq në pajtimin e komuniteteve etnike dhe përmirsimin e situatës ekonomike. Stanković theksoi që zhvillimi ekonomik i këtyre tri komunave është parakusht për stabilitetin rajonal. Ai shtoi se Trupi Koordinues gjatë periudhës 12 vjeçare në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë ka investuar 75 milionë euro, derisa bashkësia ndërkombëtare këto komuna i ka mbështetur me 35 milionë euro.

Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Sërbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë është formuar me 16 dhjetor 2000 në Bujanoc, në seancën e përbashkët të Qeverisë së RFJ-së dhe Qeverisë së Republikës së Sërbisë.

- **Viti paraparak përfundoi me sukses, u planifikuan aktivitetet për vitin e ardhshëm** – Shërbimi i Trupit Koordinues ka analizuar punën dhe rezultatet në vitin 2012 dhe ka përgatitur propozim planin e aktiviteteve për vitin e ardhshëm.

Në vitin 2013 do të përfundojë ndërtimi dhe furnizimi me mjete të nevojshme për punën e maternitetit në Preshevë dhe do të ndërtohet ndërtesa e paraleles së fakultetit Ekonomik nga Subotica në Bujanoc.



Shërbimi i Trupit Koordinues do të vazhdojë t'i ndihmojë zhvillimit ekonomik në këto tri komuna. Vitin e ardhshëm do të ndahen 60 milionë dinarë mjete të pakthyeshme.

Gjatë vitit 2013 do të përkthehen në gjuhën shqipe të gjitha tekstet e nevojshme për studentët e vitit të tretë dhe katërt të paraleles së fakultetit Ekonomik. Shërbimi i Trupit Koordinues do të vazhdojë të sigurojë tekstet shkollore për parashkollorët dhe nxënësit e shkollave fillore.

Këto janë vetëm disa nga aktivitetet me të cilat Shërbimi i Trupit Koordinues në kuadër të kompetencave të veta, do të mundohet që të avancojë kualitetin e jetës së qytetarëve të këtyre tri komunave.

Republika e Sërbisë Trupi Koordinues për komunat  
Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë

Tel: 011 21 20 906  
011 21 20 907  
Faks: 011 21 20 909

E-mail: [office@kt.gov.rs](mailto:office@kt.gov.rs)